

Philip Morris Albania SH.P.K.

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

Përmbajtja

Raporti i Audituesit të Pavarur	i
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
1. Informacion i përgjithshëm	5
2. Politika të rëndësishme kontabël	5
3. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël	13
4. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara	14
5. Standarde dhe interpretime të reja	16
6. Manaxhimi i rrezikut financiar	16
7. Menaxhimi i kapitalit	20
8. Aktive afatgjata materiale	21
9. Aktive me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë	22
10. Aktive tatimore të shtyra	23
11. Inventari	24
12. Llogari dhe të tjera të arkëtueshme	24
13. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	25
14. Kapitali Aksionar	25
15. Furnitorë dhe detyrime të tjera	25
16. Të ardhurat	26
17. Kosto e mallrave të shitur	26
18. Shpenzime të shitjes, distribucionit dhe administrative	26
19. Të ardhura/shpenzime të tjera	27
20. Fitim/ (humbje) nga kursi i këmbimit	28
21. Kosto financiare, neto	28
22. Tatimi mbi fitimin	28
23. Detyrime të mundshme	29
24. Transaksionet me palët e lidhura	30
25. Ngjarje pas datës së raportimit	31

Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar aksionerit të Philip Morris Albania SH.P.K.

Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Philip Morris Albania SH.P.K. ("Shoqëria") më 31 dhjetor 2019, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ne kemi audituar

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përfshijnë:

- pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2019;
- pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë politikat e rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin *Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare* të raportit tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

Informacione të tjera

Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për përgatitjen e informacioneve të tjera. Informacionet e tjera të cilat pritet të na vendosen në dispozicion pas datës së raportit tonë përfshijnë Raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe Raportin e drejtimit të brendshëm (por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit).

Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacionet e tjerat dhe ne nuk shprehim asnjë formë sigurie në lidhje me to.

Ky version i raportit tonë është përkthim i versionit origjinal të përgatitur në gjuhën Angleze. Ndërkohë, janë marrë të gjitha masat që përkthimi të jetë një paraqitje sa më e mirë e versionit origjinal. Megjithatë, në lidhje me çështjet e interpretimit të informacionit, këndvështrimet apo opinionet, versioni i raportit tonë në gjuhën origjinale ka përparësi ndaj këtij përkthimi.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera dhe, gjatë këtij procesi, të vlerësojmë nëse informacionet e tjera nuk pajtohen në mënyrë të rëndësishme me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që ne kemi mbledhur gjatë auditimit, ose nëse informacionet e tjera përmbajnë anomali të rëndësishme.

Kur ne të lexojmë informacionet e tjera, nëse ne arrijmë në përfundimin se në to gjenden anomali të rëndësishme, ne jemi të detyruar t'ia komunikojmë këto çështje personave të ngarkuar me qeverisje.

Përgjegjësitë e drejtimit në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi i Shoqërisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollat e brendshme, të cilat drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një anomali materiale. Anomali mund të vijë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalisë materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një anomali materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një anomali si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm që mund të jenë të nevojshme për hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtimi.
- Arrijmë në një përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtimi dhe, bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit.



Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që sigurohet paraqitja e drejtë.

Ne komunikojmë me drejtimin, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontroleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

PricewaterhouseCoopers Audit Sh.p.k.

PricewaterhouseCoopers Audit SH.P.K.

27 mars 2020

Tiranë, Shqipëri

Auditues Ligjor

Jonid Lamllari

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.

(Shumat në mijë LEK, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)


Pasqyra e pozicionit financiar

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Aktivët			
Aktivët afatgjata:			
Aktive afatgjata materiale	8	80,662	72,165
Aktive me të drejtë përdorimi	9	91,064	-
Aktive tatimore të shtyra	10	12,265	6,869
		183,991	79,034
Aktivët afatshkurtra:			
Inventari	11	1,822,469	1,152,148
Llogari dhe të tjera të arkëtueshme	12	129,079	38,928
Tatim fitimi i arkëtueshëm		25,233	11,093
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	13	922,705	1,002,728
		2,899,486	2,204,897
Totali i aktiveve		3,083,477	2,283,931
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali aksionar	11	29,000	29,000
Vlera e shërbimeve të marra nga punonjësit		19,555	17,546
Fitimi i pashpërndarë		160,887	294,881
		209,442	341,427
Detyrimet afatgjata			
Detyrime për qiranë	9	17,702	-
		17,702	-
Detyrimet afatshkurtra:			
Furnitorë dhe detyrime të tjera	15	2,780,472	1,942,504
Detyrime për qiranë	9	75,861	-
		2,856,333	1,942,504
Totali i detyrimeve		2,874,035	1,942,504
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		3,083,477	2,283,931

Pasqyrat financiare janë miratuar dhe firmosur nga Drejtimi i Philip Morris Albania Sh.p.k më 1 Mars 2020.



Administratori i Përgjithshëm
Radmilo Vlacic



Menaxher/Finance
Bledar Beta

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.

(Shumat në mijë LEK, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhurat	16	10,756,335	10,659,943
Kosto e mallrave të shitura	17	(9,884,933)	(9,672,500)
Fitimi bruto		871,402	987,443
Shpenzime distribucioni			
Shpenzime administrative	18	(438,658)	(331,515)
Të ardhura të tjera	18	(323,144)	(329,894)
Shpenzime të tjera	19	107,460	9,872
Fitim nga kurset e këmbimit	19	(26,460)	(12,055)
Te ardhura të veprimtarisë së shfrytëzimit	20	8,077	43,995
Shpenzim për interesa		198,677	367,846
Të ardhura nga interesat			
Kostot financiare neto	21	(3,222)	(7,263)
		1,756	2,050
Fitimi para tatimit		197,211	362,633
Shpenzime për tatim fitimin			
	22	(36,324)	(67,752)
Fitimi për vitin		160,887	294,881
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		160,887	294,881

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri 31 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.

(Shumat në mijë LEK, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

Pasqyra e ndryshimeve në kapital

	Kapitali i paguar	Vlera e shërbimeve të marra nga punonjësit	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2018	29,000	16,538	149,435	194,973
Fitimi neto i periudhës	-	-	294,881	294,881
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	294,881	294,881
Vlera e shërbimeve të marra nga punonjësit	-	1,008	-	1,008
Dividend i deklaruar/paguar	-	-	(149,435)	(149,435)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	29,000	17,546	294,881	341,427
Fitimi neto i periudhës	-	-	160,887	160,887
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	160,887	160,887
Vlera e shërbimeve të marra nga punonjësit	-	2,009	-	2,009
Dividend i deklaruar/paguar	-	-	(294,881)	(294,881)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	29,000	19,555	160,887	209,442

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri 31 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.

(Shumat në mijë LEK, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

Pasqyra e flukseve monetare

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të ardhurat nga veprimtaria shfrytëzimit		197,211	362,633
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	8	42,034	49,853
Zhvlerësimi dhe amortizimi aktive me të drejtë përdorimi	9	34,557	-
Humbje nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		5,829	(3,195)
Humbje nga aktive me të drejtë përdorimi		305	-
Kosto financiare, neto	21	1,465	5,214
Vlera e shërbimeve të marra nga punonjësit		2,009	1,008
Te ardhurat nga veprimtaria shfrytëzimit përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues		283,410	415,513
Ndryshimet në kapitalin qarkullues:			
(Rritje)/ulje ne inventar	11	(670,322)	(65,339)
(Rritje)/ulje në llogari dhe të tjera të arkëtueshme	12	(90,151)	(23,871)
Rritje/(ulje) e detyrimeve ndaj furnitorëve dhe detyrime të tjera	15	837,970	359,076
Flukset neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit përpara pagesës së interesit dhe tatimit mbi fitimin		360,907	685,379
Tatimi mbi fitimin i paguar		(55,860)	(64,692)
Interesa të paguara	21	1,756	(5,214)
Flukset monetare neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit		306,803	615,472
Flukset monetare nga veprimtaritë investuese			
Blerje aktiveve afatgjata materiale	8	(56,359)	(11,684)
Të afirdhurat nga shitja e aktiveve afatgjata		-	3,195
Flukset monetare neto nga veprimtaritë investuese		(56,359)	(8,489)
Flukset monetare nga veprimtaritë financiare			
Pagesa e qirasë	9	(35,585)	
Pagesa e dividendit		(294,882)	(149,436)
Flukset neto nga veprimtaritë financiare		(330,467)	(149,436)
		-	-
Rritja neto e mjeteve monetare dhe të tjera ekuivalente		(80,023)	457,547
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente në fillim të vitit		1,002,728	545,181
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente në fund të vitit		922,705	1,002,728

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri 31 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Pasqyrat financiare të Philip Morris Albania sh.p.k. ("Shoqëria") janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019.

Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar themeluar në Tiranë, Shqipëri dhe regjistruar me Vendim të Gjykatës së Tiranës nr. 36432, datë 30 tetor 2006 në përputhje me ligjin shqiptar nr. 7638, datë 19 Nentor 1992: "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".

Aktivitetet kryesore të Shoqërisë janë: blerje, shitje, import, eksport i produkteve të duhanit dhe pajisje dhe aksesori të lidhura me to, si dhe aktivitete promovuese përkatëse. Shoqëria shet këto marka cigaresh: Marlboro, Philip Morris, L&M, Merit dhe Heets si dhe pajisje elektronike dhe aksesori. Aktivitetet e Shoqërisë janë kryer në kuadër të territorit të Republikës së Shqipërisë.

Aksionari i vetëm i Shoqërisë është Philip Morris SA, një Shoqëri e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Zvicrës.

Administratorët e Shoqërisë janë: Z. Radmilo Vlacic dhe Z. Lorent Gordi.

Zyra e regjistruar e shoqërisë është në Tiranë në rrugën "Murat Toptani", Qendra Eurocol, Kati 10. Shoqëria është e regjistruar si person i tatueshëm në Qarkun Tiranë, në njësinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, me numër e identifikimi K71405001S.

Shoqëria ka punësuar 42 punonjës deri më 31 dhjetor 2019 (2018: 40 punonjës).

2. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare shpjegohen më poshtë. Këto politika janë aplikuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, përveçse kur është përcaktuar ndryshe.

Baza e përgatitjes. Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) sipas konventës së kostos historike.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë të përgatitura mbi bazën e parimit të vijmësisë, e cila supozon që Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit operacional për një periudhë kohore të papërcaktuar.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon përdorimin e disa vlerësimeve dhe gjykimeve kontabël të veçanta. Kërkohej gjithashtu që drejtimi të ushtrojë gjykimin e tij gjatë procesit të aplikimit të politikave kontabël të grupit. Në rastet kur kërkohej një nivel më i lartë gjykimi apo kompleksiteti, ose kur supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare, shpjegohen në shënimet shpjeguese 3.

Monedha funksionale dhe e paraqitjes së pasqyrave financiare. Këto pasqyra financiare janë të paraqitura në Lekë, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

Transaksionet dhe gjendjet. Transaksionet në valutë të huaj janë transaksione të ndërrmarra nga Shoqëria përveç atyre në monedhën funksionale. Transaksionet në valutë janë përkthyer në monedhën funksionale në kursin e këmbimit valutor në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedha të huaja janë përkthyer në lekë në kursin e këmbimit valutor në datën e raportimit. Diferencat e kursit të këmbimit që rrjedhin nga përkthimi njihen në fitim ose humbje. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare që maten në terma të kostos historike në një monedhë të huaj janë përkthyer duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksioneve.

Instrumenta financiare: termat kryesore të matjes

Vlera e drejtë. Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion midis palëve të vullnetshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe evidentohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Shoqërisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

2.Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare të tregtuara në një treg aktiv matet si produkt i çmimit të kuotuar për aktivin ose pasivin individual dhe numrit të instrumenteve të mbajtura nga Shoqëria. Ky është rasti edhe nëse vëllimi normal i tregtisë ditore të tregut nuk është i mjaftueshëm për të absorbuar sasinë e mbajtur dhe për të vendosur urdhër për të shitur pozicionin në një transaksion të vetëm mund të ndikojë në çmimin e kuotuar.

Teknikat e vlerësimit siç janë modelet e skontimit të flukseve të mjeteve monetare ose modele të bazuara në transaksionet e fundit të krahit të punës ose shqyrtimi i të dhënave financiare të investuarve përdoren për të matur vlerën e drejtë të instrumenteve të caktuara financiare për të cilat informacioni i çmimeve të tregut të jashtëm nuk është i disponueshëm. Matjet e vlerës së drejtë analizohen sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë si vijon: (i) niveli i parë janë matjet me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për aktivet ose detyrimet identike, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknikat e vlerësimit me të gjitha inputet materiale (iii) matjet e nivelit të tretë janë vlerësime që nuk bazohen vetëm në të dhënat e observueshme të tregut (domethënë matja kërkon hyrje të rëndësishme të pakontrollueshme). Transfertet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë konsiderohen se kanë ndodhur në fund të periudhës raportuese.

Kostot e transaksionit janë kosto shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes, lëshimit ose shitjes së një instrumenti financiar. Një kosto shtesë është ajo që nuk do të kishte ndodhur nëse transaksioni nuk do të kishte ndodhur. Kostot e transaksionit përfshijnë tarifën dhe komisionet që u paguhen agentëve (përfshirë punonjësit që veprojnë si agentë shitës), këshilltarët, agjentët dhe tregtarët, taksat nga agjencitë rregullatore dhe shkëmbimet e letrave me vlerë dhe transferimin e taksave dhe detyrimeve. Kostot e transaksionit nuk përfshijnë primet e borxheve ose zbritjet, kostot e financimit ose shpenzimet e brendshme administrative ose të mbajtjes.

Kostoja e amortizuar ("KA") është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në njohjen fillestare duke zbritur çdo ripagim kryesor, plus interesin e përlogaritur dhe për aktivet financiare minus çdo kompensim për humbjet e pritshme të kredisë ("HPK"). Interesi i përlogaritur përfshin amortizimin e kostove të transaksionit të shtyra në njohjen fillestare dhe të çdo primi ose zbritje në shumën e maturimit duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat e akumuluar të interesit dhe shpenzimet e interesit të përlogaritur, duke përfshirë edhe kuponin e akumuluar dhe zbritjen ose shpërblimin e amortizuar (përfshirë tarifën e shtyra në fillim, nëse ka), nuk paraqiten veças dhe përfshihen në vlerat bartëse të zërave në pasqyrën e pozicionit financiar.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e ndarjes së të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse, në mënyrë që të arrihet një normë periodike konstante e interesit (norma efektive e interesit) në vlerën kontabël. Norma efektive e interesit është norma që zbritet pagesat e ardhshme të parasë ose faturat (duke përjashtuar humbjet e ardhshme të kredisë) nëpërmjet jetës së pritshme të instrumentit financiar ose një periudhe më të shkurtër, nëse është e përshtatshme, në vlerën kontabël neto të instrumentit financiar. Norma efektive e interesit zbritet fluksin e mjeteve monetare të instrumenteve me interes të ndryshueshëm deri në datën e ardhshme të interesit, përveç primeve ose zbritjes që pasqyrojnë diferencën e kredisë mbi normën e variueshme të specifikuar në instrument ose variabla të tjerë që nuk rivendosen në normat e tregut. Primet ose zbritjet e tilla amortizohen gjatë tërë jetës së pritshme të instrumentit. Llogaritja e vlerës aktuale përfshin të gjitha pagesat e paguara ose të marra midis palëve në kontratë që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit.

Instrumentet financiare – njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshmohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e zbritshme për humbje të pritshme të kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Aktivitetet financiare – klasifikimi dhe matja e mëpasme – kategoritë e matjes. Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA (sipas paragrafit më lart). Klasifikimi dhe matja e mëpasme e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) Modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve dhe (ii) karakteristikat e fluksit monetar të aktivitetit.

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matja e mepasme – modeli i biznesit. Modeli i biznesit reflekton mënyrën sesi Shoqëria menaxhon aktivet për të gjeneruar fluks monetar – nëse objektivi i Shoqërisë është: (i) vetëm mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale (“mbajtja për mbledhje e flukseve monetare”) ose (ii) mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe të flukseve monetare që gjenerohen nga shitja e aktiveve (“mbajtja për mbledhje e flukseve monetare dhe shitje”) ose, nëse objektivi (i) dhe (ii) është jo i aplikueshëm, aktivet financiare klasifikohen si pjesë e modelit të biznesit “të tjera” dhe maten në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet financiare individuale (në nivel individual) bazuar në të gjithë evidencën përkatëse për aktivitetet që Shoqëria ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin individual në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga Shoqëria në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si kompensohen menaxherët. Referojuni Shënimit 3 për gjykimet kritike të aplikuara nga Shoqëria në përcaktimin e modeleve të biznesit për aktivet e saj financiare.

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matja e mëpasme – karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare. Kur modeli i biznesit ka si objektivi mbajtjen e aktiveve për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale ose mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe për të shitur, Shoqëria vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit (“VPPI”). Gjatë këtij vlerësimi, Shoqëria konsideron nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, pra interesi përfshin vetëm shumën për rrezikun e kredisë, vlerën kohore të parasë, risqet e tjera bazë të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, aktivi financiar klasifikohet dhe matet me VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivilësohet më pas. Referojuni Shënimit 3 për gjykimet kritike të aplikuara nga Shoqëria në kryerjen e testit VPPI për aktivet e saj financiare.

Aktivet financiare - riklasifikimi. Instrumentet financiare riklasifikohen vetëm kur modeli i biznesit për menaxhimin e portofolit në tërësi ndryshon. Riklasifikimi ka një efekt të ardhshëm dhe zhvillohet që nga fillimi i periudhës së parë të raportimit që vijon pas ndryshimit të modelit të biznesit. Shoqëria nuk ka ndryshuar modelin e saj të biznesit gjatë periudhës aktuale dhe asaj krahasuese, dhe nuk ka bërë ndonjë riklasifikim.

Aktivet financiare – fshirja. Aktivet financiare fshihen tërësisht ose pjesërisht, kur Shoqëria ka kryer cdo përpjekje për rimarrjen dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rimarrjen. Fshirja përfaqëson një rast të çregjistrimit. Treguesit që nuk ka pritshmëri të arsyeshme të rimarrjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mosshlyerjes, paafësi paguese dhe falimentim. Shoqëria mund të fshijë aktivet financiare që janë subjekt i zbetimit me force të marreveshjes kur Shoqëria kërkon të rikuperojë shumat që janë të arkëtueshme sipas termave kontraktuale, megjithatë, nuk ka pritshmëri të arsyeshme për marrjen e tyre.

Aktivet financiare – çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) aktivet shlyhen ose të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet përfundojnë ose (b) Shoqëria ka transferuar të drejtat për arkëtimin e flukseve monetare nga aktivet financiare ose ka hyrë në një marrëveshje likuidimi ndërkohë që (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiveve ose (ii) as nuk transferon dhe as nuk mban të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por nuk ruan kontrollin e këtyre aktiveve.

Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Shoqëria rikalkulon vlerën kontabël bruto duke skontuar flukset monetare kontraktuale të modifikuara me normën fillestare të interesit efektiv dhe një fitim ose humbje modifikimi në fitim ose humbje.

Detyrimet financiare – kategoritë e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura në KA, përveç (i) detyrimeve financiare të matura me VDNFH: ky klasifikim aplikohet për derivativet, detyrimet financiare të mbajtura për shitje (p.sh. pozicionet afatshkurtra me letra me vlerë), shuma e kushtëzuar e njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Detyrimet financiare – çregjistrimi. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato likuidohen (d.m.th. kur detyrimi i specifikuar në kontratë paguhet, anulohet ose skadon).

Një shkëmbim ndërmjet Shoqërisë dhe huadhënësve të saj të origjinës të instrumenteve të borxhit me kushte shumë të ndryshme, si dhe modifikime thelbësore të termave dhe kushteve të detyrimeve financiare ekzistuese, llogariten si shlyerje e detyrimit financiar fillestar dhe njohja e një detyrimi të ri financiar. Kushtet janë thelbësisht të ndryshme në qoftë se vlera e skontuar e flukseve të mjeteve monetare sipas kushteve të reja, duke përfshirë çdo pagesë të paguar neto nga çdo tarifë e marrë dhe zbritur duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv, është të paktën 10% ndryshe nga vlera aktuale e skontuar e flukset monetare të mbetura të detyrimit financiar fillestar. Nëse një shkëmbim i instrumenteve të borxhit ose modifikimi i kushteve llogaritet si shlyerje, çdo shpenzim ose tarifë e shkaktuar njihet si pjesë e fitimit ose humbjes në shlyerje.

Detyrimet financiare të përcaktuara në VDNFH. Shoqëria mund të përcaktojë detyrime të caktuara në VDNFH në njohjen fillestare. Fitimet dhe humbjet nga detyrimet e tilla janë paraqitur në fitim ose humbje, përveç shumës së ndryshimit në vlerën e drejtë që i atribuohet ndryshimeve në rrezikun e kredisë të atij detyrimi (përcaktuar si shumë që nuk i atribuohet ndryshimeve në kushtet e tregut që japin rritje në rrezik tregu), i cili regjistrohet në OCI dhe nuk riklasifikohet më pas në fitim ose humbje. Kjo ndodh nëse një prezantim i tillë nuk do të krijonte ose do të zgjeronte një mospërputhje kontabël, në të cilin rast fitimet dhe humbjet që i atribuohen ndryshimeve në rrezikun e kredisë së pasivit gjithashtu paraqiten në fitim ose humbje. Shoqëria nuk ka detyrime financiare të përcaktuara në VDNFH.

Netimi i instrumenteve financiare. Aktivet dhe detyrimet financiare netohen dhe shumata neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për netimin e shumave të njohura dhe ekziston qëllimi për shlyerje në baza neto ose realizimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë netimi (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast mospagese dhe (iii) në rast të paafësisë paguese ose falimentimit.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në arkë dhe depozitat rrjedhëse në banka apo investime të tjera likuide afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to mbahen në KA sepse: (i) ato mbahen për mbledhjen e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe këto flukse monetare kontraktuale reflektojnë VPPI (ii) dhe nuk janë të dizenuara me VDNFH.

Llogaritë e arkëtueshme. Llogaritë e arkëtueshme janë njohur fillimisht me vlerë të drejtë dhe në vazhdim mbarten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Llogari të pagueshme. Llogaritë e pagueshme njihen kur pala tjetër përmbush detyrimet e saj të performancës sipas kontratës dhe matet fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas mbahet me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Garancitë financiare. Garancitë financiare janë kontrata të përvokueshme që kërkojnë nga Shoqëria që të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar mbajtësin e garancisë për një humbje që ka për shkak se një debitor i specifikuar nuk arrin të bëjë pagesën në kohën e duhur në përputhje me kushtet e një instrumenti borxhi. Garancitë financiare fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, e cila normalisht evidentohet nga shumata e tarifave të pranuar. Kjo shumë amortizohet në bazë të vijës së drejtë gjatë jetës së garancisë.

Në fund të secilës periudhë raportuese, garancitë maten më të larta se (i) shumata e alloëance së humbjes për ekspozimin e garantuar të përcaktuar bazuar në modelin e pritjes të humbjes dhe (ii) bilanci i mbetur i paamortizuar i shumës në njohjen fillestare.

Inventari. Inventarët maten me çmimin më të ulët dhe me vlerën neto të realizueshme. Kostoja e inventarëve bazohet në metodën specifike të identifikimit dhe përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e konvertimit dhe kostot e tjera të shkaktuara në sjelljen e inventarëve në vendin dhe gjendjen e tyre aktuale. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, duke zbritur kostot e vlerësuar të kompletimit dhe shpenzimeve të shitjes.

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Të arkëtueshmet e tjera. Në llogaritë e arkëtueshmëve të tjera, përfshihen parapagimet dhe aktivet tjera . Parapagimet mbahen me kosto minus provigjionin për zhvlerësim. Një parapagim klasifikohet si afatgjatë kur mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin pritet të merren pas një viti ose kur parapagimi lidhet me një aktiv që vetë klasifikohet si jo-aktuale pas njohjes fillestare. Parapagimet për blerjen e asetëve transferohen në vlerën kontabël neto të aktivit sapo Shoqëria merr kontrollin e aktivit dhe është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme që lidhen me aktivin do të rrjedhin në Shoqëri. Pagesat paraprake të tjera shënohen në fitim ose humbje kur merren mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimet. Nëse ka një indikacion se asetet, mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin nuk do të pranohen, vlera bartëse e parapagimit shënohet në përputhje me rrethanat dhe një humbje përkatëse e zhvlerësimit njihet në fitim ose humbje për vitin.

Aktivet afatgjata materiale. Aktivet afatgjata materiale janë paraqitur me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe minus humbjet nga impairment, nëse ka. Kostoja përfshin të gjitha shpenzimet që i atribuohen drejtpërsëdrejti blerjes së artikujve. Shpenzimet pasuese përfshihen në vlerën kontabël të aktiveve ose njihen si një aktiv i veçantë, vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme që lidhen me artikullin do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e artikullit mund të matet në mënyrë të besueshme.

Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera njihen në fitim ose humbje kur ndodhin. Kur pjesët e pronës dhe pajisjeve kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të veçantë (përbërës kryesorë) të pronës dhe pajisjeve. Në çdo fund të çdo date të raportimit, Drejtimi vlerëson nëse ka ndonjë tregues të zhvlerësimit të pronës, impianteve dhe pajisjeve.

Nëse ndonjë tregues i tillë ekziston, Drejtimi vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si vlera më e lartë e drejtë e një aktivit minus kostot për shitje dhe vlerën e saj në përdorim. Vlera kontabël është zvogëluar në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin në masën që tejkalon tepërcën e mëparshme të rivlerësimit në kapitalin neto. Një humbje nga zhvlerësimi i njohur për një aktiv në vitet paraprake shfuqizohet ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e aktivit në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot për shitje.

Zhvlerësimi llogaritet në baza lineare për të alokuar koston e tyre për vlerat e tyre të mbetura gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar. Toka nuk zhvlerësohet.

Jeta ekonomike e aktiveve për periudhën aktuale është si më poshtë:

- | | |
|---------------------------------------|--------|
| • Makineri dhe pajisje | 5 vjet |
| • Mjete transporti | 4 vjet |
| • Kompjuterat dhe pajisje informatike | 3 vjet |

Vlera e mbetur dhe jetëgjatësia e dobishme e vlerësuar e aktiveve rishikohet dhe, nëse është e nevojshme, rregullohet në secilën të datë të pozicionit financiar. Kur vlera kontabël neto e një aktivit është më e madhe se shumata e rikuperueshme e vlerës së saj, ajo shënohet menjëherë në shumën e rikuperueshme.

Aktive me të drejtë përdorimi. Shoqëria ka marrë me qira aktive të ndryshme përfshirë ambjentet e përdorura si zyrë dhe për magazinim, makina dhe shtëpi për punonjësit e huaj. Kontratat mund të përfshijnë elemente që lidhen drejtpërdrejt me qira ose jo. Shoqëria ka shpërndarë koston e elementeve që lidhen me qiranë ose jo bazuar në çmimet e secilit element.

Aktivitet që janë marrë nëpërmjet qirasë vlerësohen në bazë të aktualizimit të flukseve të ardhshme dalëse.

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Aktivet me të drejtë perdorimi maten bazuar në kosto të përbëre nga elementët e mëposhtëm:

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë
- çdo pagesë të qirasë të bërë para ose në datën e fillimit, minus çdo stimul qiraje të marrë
- çdo kosto fillestare të drejtpërdrejtë të kryer nga qiramarrësi
- kostot për të kthyer aktivin në gjendjen e kërkuar nga kontrata e qirasë

Aktivet me të drejtë perdorimi amortizohen me vlerën më të vogël mes jetës së dobishme të aktivit dhe kohëzgjatjes së kontratës. Nëse ekziston një mundësi e arsyeshme për të blerë aktivin, e drejta e përdorimit të aktivit amortizohet bazuar në jetën e dobishme. Amortizimi i të drejtës së përdorimit të aktivit llogaritet në bazë lineare bazuar në jetën e dobishme.

	Jeta ekonomike
Ndërtesa	4
Mjete transporti	4
Të tjera	2

Zhvlërësimi i aktiveve jo-financiare. Aktivet jo-materiale që kanë një jetëgjatësi të dobishme të papërcaktuar ose aktive jo-materiale jo të gatshme për përdorim nuk janë subjekt i amortizimit dhe testohen çdo vit për zhvlërësim. Aktivet që i nënshtrohen zhvlërësimit dhe amortizimit rishikohen për zhvlërësim sa herë që ngjarjet ose ndryshimet në rrethanat tregojnë se vlera kontabël neto mund të mos jetë e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlërësimi njihet për shumën me të cilën shuma bartëse e aktivit tejkalon shumën e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë e drejtë e një aktivi minus kostot e nxjerrjes nga përdorimi dhe vlerës në përdorim.

Kapitali aksionar. Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet me vlerë nominale

Dividendët. Dividendët regjistrohen si pasiv dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë deklaruar dhe miratuar. Çdo dividend i deklaruar pas periudhës raportuese dhe para se pasqyrat financiare të autorizohen për t'u lëshuar, vendosen në shënimin e ngjarjeve të mëvonshme.

Njohja e të ardhurave. Të ardhurat i përkasin aktiviteteve të zakonshme të Shoqërisë. Të ardhurat njihen në shumën e çmimit të transaksionit. Çmimi i transaksionit është shuma për të cilën Shoqëria pret t'i përkasi në këmbim të transferimit të kontrollit mbi mallrat apo shërbimet e premtuara për një klient.

Të ardhurat njihen neto nga zbritjet, kthimet dhe tatimet mbi vlerën e shtuar.

Shitjet e mallrave. Shitjet njihen kur kontrolli i mallit është transferuar, kur mallrat janë dorëzuar tek klienti, konsumatori ka liri të plotë mbi mallrat dhe nuk ka detyrim të paplotësuar që mund të ndikojë në pranimin e mallrave të klientit. Dorëzimi ndodh kur mallrat janë vënë në dispozicion të klientit, rreziqet e vjetërsisë dhe humbjes janë transferuar tek klienti dhe konsumatori ka pranuar mallrat në përputhje me kontratën, dispozitat e pranimin janë anuluar ose Shoqëria ka dëshmi objektive se të gjitha kriteret për pranim janë përmbushur. Të ardhurat nga shitjet me zbritje njihen në bazë të çmimit të specifikuar në kontratë, netim nga zbritjet e llogaritura.

Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose për tu arkëtuar nga mallrat dhe shërbimet e shitura në rrjedhën e zakonshme të aktivitetit të shoqërisë. Të ardhurat janë paraqitur me vlerën e tyre neto nga TVSH, kthimet dhe zbritjet. Shoqëria njeh të ardhurat kur shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që shoqëria do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe kur plotësohen kriteret e caktuara siç përshkruhet më poshtë. Shoqëria shet një gamë produktesh duhani në tregun me shumicë. Shitja e mallrave njihet kur shoqëria ka dërguar mallrat tek shitësi me shumicë (referuar më poshtë si distibitori), distributor ka liri veprimi mbi mallrat dhe çmimin e shitjes dhe nuk ka asnjë detyrim të papërmbushur që mund të ndikojnë në pranimin e produkteve. Dorëzimi nuk ndodh derisa produktet janë dërguar në një vend të caktuar, rreziku i dëmtimit dhe humbjes është transferuar te distributor, dhe distributori ka pranuar mallrat sipas kontratës së shitjes, dhe mundësisë së mos-pranimin i ka kaluar afati, ose shoqëria ka një evidencë objektive që të gjitha kriteret e pranimin janë plotësuar.

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Shitjet janë rregjistruar në bazë të çmimit të përcaktuar në kontratën e shitjes, neto nga çdo zbritje nga çmimi i shitjes në momentin e shitjes. Përvoja e akumuluar është përdorur për të vlerësuar dhe siguruar zbritjet.

Komponentët e financimit. Shoqëria nuk pret që të ketë kontrata ku periudha ndërmjet transferimit të mallrave ose shërbimeve të premtuara ndaj klientit dhe pagesa nga klienti tejkalon një vit. Si pasojë, Shoqëria nuk rregullon asnjë nga çmimet e transaksionit për vlerën kohore të parasë.

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare. Të ardhurat nga financimi përfshijnë të ardhura nga interesat në bilancet me bankat. Të ardhurat nga interesi njihen si akruale, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huamarrjet.

Fitimet dhe humbjet në valutë të huaj raportohen në baza neto si të ardhura financiare ose kosto financiare, duke vlerësuar nëse lëvizjet në valutë janë në një fitim neto ose në një pozicion neto humbjeje.

Përfitimet e punonjësve

Përfitimet afatshkurtra

Në emër të punonjësve të saj, shoqëria paguan sigurime shoqërore dhe shëndetësore të cilat janë te llogaritura mbi pagën bruto të paguar, si dhe tatim mbi të ardhurat personale mbi pagat i cili është llogaritur mbi pagën bruto. Përveç kësaj, shpenzime për vakte dhe bonuse për pushime janë paguar në përputhje me legjislacionin vendas. Këto shpenzime janë regjistruar në fitim ose humbje në periudhën në të cilën shpenzimet për paga kanë ndodhur.

Ndarja e përfitimeve dhe bonuset

Shoqëria e njeh detyrimin e saj dhe shpenzimet për të siguruar shpërblime punonjësve (bonuse), kur ka një praktikë të kaluar që ka krijuar një detyrim konstruktiv dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i detyrimit.

Pagesa të bazuara në aksione

Philip Morris International Inc parashikon plane kompensimi në aksione për manaxhimin e të gjitha shoqërive Philip Morris Group. Këto plane parashikojnë kompensimin nëpërmjet pagesave të bazuara në aksione të kapitalit neto. Shoqëria ndërmerr plane nxitëse në të cilat punojësit e kualifikuar për të përfituar nga skema marrin si shpërblim aksione të shtyra në kohë ku mbas një periudhe tre vjeçare (periudhë e kushtëzimit) shërbimi këto aksione mund të përfitohen. Kostoja e kompensimit për aksionet e shtyra përcaktohet mbi bazën e vlerës së drejtë të instrumentave të kapitalit të dhëna në datën e dhënies (vlera e drejtë e aksioneve përcaktohet në datën e dhënies).

Vlera e drejtë e shërbimeve të marra nga punojësit në këmbim të dhënies së aksioneve njihet si shpenzim. Shumat totale që duhet të shpenzohen përcaktohen duke iu referuar vlerës së drejtë të aksioneve të dhëna, duke përjashtuar ndikimin e efekteve të shërbimeve të pa lidhura me tregun dhe efektin e kushtëzimeve të performancës të përcaktuar për të përfituar aksionet (psh, përfitueshmëria, objektivat e rritjes së shitjeve, kohëzgjatja e bashkëpunimit me punojësin përcaktuar mbi një periudhë kohore të specifikuar).

Kostoja e kompensimit është e njohur gjatë periudhës së kushtëzimit, periudhë në të cilën priten të plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara. Arritjet e kushtëzimeve të shërbimit dhe të shërbimeve të pa lidhura me tregun përfshihen në ngritjen e pritshmërive rreth numrit të aksioneve që do të përfitohen nga punojësit. Kjo pritshmëri rishikohet çdo datë raportimi dhe varianca ngarkohet në fitim/humbje, me një axhustim korrespondent në kapital. Në rast ndryshimi të numrit të përfituar nga numri i pritur si rrjedhojë e mos arritjes së kushteve të tregut (p.sh çmimi per kuotë, kthimi për kuotë) asnjë ndryshim nuk regjistrohet në fitim/humbje. Të ardhurat nga ushtrimi i opsionit neto për kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt kreditohen në kapitalin aksionar (vlera nominale). Opsionet e anuluar konsiderohen të përfituara në momentin e anulimit. Çdo shpenzim i paamortizuar lidhur me dhëniet ngarkohet në fitim ose humbje menjëherë.

Kostot e kompensimit njihen bazuar në metodën lineare përgjatë periudhës së kushtëzimit ku ngarkohen si shpenzim për përfitimet e punojësve dhe një hyrje korrespondente në kapital. Grupi operon disa skema kompensimi bazuar në mjete monetare dhe instrumente kapitali ku Shoqëria përfiton mallra dhe shërbime nga punonjës dhe të tretë në këmbim të instrumenteve të kapitalit të grupit.

Detyrime për qiranë. Detyrimet për qiranë maten në bazë të aktualizimit të flukseve të ardhshme dalëse monetare. Detyrimet për qiranë përfshijnë vlerën aktuale të pagesave të mëposhtme:

- pagesa fikse, të pakësuara nga çdo stimul qiraje të marrë
- pagesat variabël të qirasë të cilat varen nga një indeks ose normë, e matur fillimisht duke përdorur një indeks ose normë në datën e fillimit

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

- shumat e pritshme për t'u paguar nga Shoqëria sipas vlerës së mbetur të garancive
- cmimi i ushtrimit të opsionit të blerjes nëse Shoqëria është e sigurt për ushtrimin e këtij opsioni
- pagesat e penaliteteve për përfundimin e qirasë, nëse Shoqëria mendon ta ushtrojë këtë opsion.

Mundesitë e shtyrjes dhe përfundimit janë të përfshira në një numër të konsiderueshëm të qirave për aktivet e Shoqërisë. Këto kushte përdoren për të maksimizuar fleksibilitetin operacional në menaxhimin e aseteve që Shoqëria përdor për operacionet e saj. Pjesa më e madhe e opsioneve të shtyrjes dhe përfundimit janë të ushtrueshme vetëm nga ana e Shoqërisë dhe jo nga qiradhënësi. Opsionet e shtyrjes janë përfshirë në periudhën e qirasë nëse qiraja është në mënyrë të arsyeshme e mundur për tu shtyrë (ose për mos u përfunduar). Pagesat e qirasë që i përkasin periudhës së shtyrjes janë të përfshira në llogaritjen e detyrimit për qiranë financiare.

Pagesat për qiranë janë të aktualizuara duke përdorur normën e përcaktuar në kontratën e qirasë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, që është dhe rasti i qirave të Shoqërisë, përdoret norma e huamarrjes e cila është norma me të cilën Shoqëria do të duhej të merrtë hua fonde për të blerë aktive me vlerë sa vlera e aktivitetit me të drejtë përdorimi në një mjedis ekonomik të ngjashëm dhe me kushte apo kolateral të ngjashëm.

Për të përcaktuar normën e huamarrjes Shoqëria:

- ku është e mundur përdor si fillim një financim të marrë nga Shoqëria, të përshtatur për të reflektuar ndryshimet nga momenti që financimi është marrë
- përdor një normë interesi pa rrezik, e ndryshuar duke marrë parasysh rrezikun e kreditit
- bën ndryshime specifike në lidhje me qiranë, për shembull termat, vendin, monedhën dhe kolateralin

Norma rritëse e huamarrjes përcaktohet nga Shoqëria mëmë për të gjitha degët e saj bazuar në specifikat lokale.

Shoqëria është e ekspozuar ndaj një rritje të mundshme në të ardhmen të pagesave të ndryshueshme të qirasë të bazuara në një indeks apo normë, të cilat nuk janë të përfshira në detyrimin për qiranë derisa të hyjnë në fuqi. Kur pagesat e ndryshueshme të qirasë të bazuara në një indeks apo normë hyjnë në fuqi, detyrimi për qiranë rillohet dhe ndryshohet kundrejt aktivitetit me të drejtë përdorimi.

Pagesat e qirasë shpërndahen midis principalit dhe kostove financiare. Kostot financiare ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së qirasë financiare në mënyrë që të krijohet një normë periodike interesi mbi balancën e mbetur të detyrimit përgjatë çdo periudhe.

Pagesat e lidhura me qiratë afatshkurtër të aktiveve dhe të gjitha qiratë për aktivet me vlerë të vogël ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Qiratë afatshkurtër janë qira me kohe zgjatje prej 12 muajsh ose më pak.

Për të optimizuar kostot përgjatë kohëzgjatjes së kontratës Shoqëria ndonjëherë krijon garanci në vlerën e mbetur për qiratë e pajisjeve. Shoqëria fillimisht llogarit dhe njeh shumën e pritshme për tu paguar nën garacinë e vlerës së mbetur si pjesë e detyrimit për qiranë. Zakonisht vlera e mbetur e pritshme në fillim të qirasë është e barabartë ose me e lartë se vlera e garancisë dhe Shoqëria nuk pret të ketë ndonjë pagesë shtesë. Në fund të çdo periudhe raportuese vlera e mbetur rishikohet dhe ndryshohet për të reflektuar vlerën aktuale të mbetur në bazë të aktiveve të tjera të krahasueshme dhe parashikimeve për çmimet në të ardhmen.

Qiraja operative. Kur Shoqëria është qiradhënëse në një qira e cila nuk transferon të gjitha rreziqet dhe përfitimet tek qiramarrësi, pagesat e qirasë njihen si të ardhura të tjera në baze lineare.

Provizjionet. Një provizjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv që mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike të kërkohet për të shlyer detyrimin.

Rezervat përcaktohen duke zbritur flukset monetare të ardhshme të pritshme me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të pasivit. Zhvendosja e zbritjes njihet si kosto financiare.

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Taksa mbi fitimin. Tatimi në të ardhurat aktuale llogaritet në bazë të rregullave të tatimit mbi të ardhurat që zbatohen në Shqipëri, duke përdorur normat tatimore të miratuara në datën e raportimit. Norma e tatimit mbi të ardhurat e korporatave është vendosur në 15% në përputhje me rregulloret tatimore shqiptare që aktualisht janë në fuqi.

Tarifa e tatimit mbi të ardhurat në fitim ose humbje për vitin përbëhet nga tatimi aktual dhe ndryshimet në tatimin e shtyrë. Tatimi aktual llogaritet në bazë të fitimit të tatueshëm të pritur për vitin duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e bilancit. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në fitim ose humbje sepse ajo përjashton zërat e të ardhurave ose shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në vite të tjera dhe përveç kësaj përjashton zërat që nuk janë kurrë të tatueshëm ose të zbritshëm. Tatimet përveç tatimit mbi fitimin regjistrohen brenda shpenzimeve operative.

Tatimi i shtyrë i fitimit llogaritet duke përdorur metodën e pasivit të bilancit për të gjitha diferencat e përkohshme që lindin midis bazës tatimore të aktiveve dhe pasiveve dhe vlerave të tyre kontabël për qëllime të raportimit financiar.

Detyrimet tatimore të shtyra njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Aktivet tatimore të shtyra njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme, bartjen e mjeteve tatimore të papërdorura dhe humbjet tatimore të papërdorura, deri në masën që është e mundur që fitimi i tatueshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit diferencat e përkohshme të zbritshme, dhe humbjet e papërdorura tatimore mund të përdoren. Vlera kontabël e aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi dhe reduktohet deri sa nuk është më e mundur që fitimi i tatueshëm i mjaftueshëm do të jetë në dispozicion për të lejuar shfrytëzimin e të gjithë ose një pjesë të aktivitetit të tatimit të shtyrë.

Aktivitetet dhe detyrimet tatimore të shtyra maten me normat tatimore që pritet të zbatohen në periudhën kur aktivi është njohur ose detyrimi është shlyer, në bazë të normave tatimore (dhe ligjeve tatimore) të cilat janë miratuar ose janë substanciale në datën e raportimit.

Aktivitetet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompesohen kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e aktiveve tatimore aktuale kundrejt detyrimeve tatimore aktuale dhe kur ka një qëllim për të shlyer gjendjet në bazë neto.

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Shoqëria merr parasysh ndikimin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse mund të jenë të detyrueshme tatimet dhe interesat shtesë. Shoqëria beson se akrualet e saj për detyrimet tatimore janë adekuate për të gjitha vitet e hapura tatimore bazuar në vlerësimin e saj të shumë faktorëve, duke përfshirë interpretimet e ligjit tatimor dhe përvojën e mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një seri gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme. Informacioni i ri mund të bëhet i disponueshëm që shkakton që Shoqëria të ndryshojë gjykimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshimet e tilla në detyrimet tatimore do të ndikojnë në shpenzimet tatimore në periudhën kur një vendim i tillë është bërë.

Tatimi mbi vlerën e shtuar. Tatimi mbi vlerën e shtuar të prodhimit, që lidhet me shitjet, paguhet tek autoritetet tatimore përpara (a) grumbullimit të të arkëtueshmeve nga konsumatorët ose (b) dërgimit të mallrave ose shërbimeve ndaj klientëve. TVSH-ja e inputeve në përgjithësi mund të rikthehet kundrejt TVSH-së së prodhimit pas marrjes së faturës së TVSH-së. Autoritetet tatimore lejojnë shlyerjen e TVSH-së në baza neto. TVSH-ja në lidhje me shitjet dhe blerjet njihen në pasqyrën e pozicionit financiar në baza bruto dhe shpalosen veçmas si një aktiv dhe pasiv. Kur është parashikuar zhvlerësimi i të arkëtueshmeve, humbja nga zhvlerësimi regjistrohet për shumën bruto të debitorit, duke përfshirë TVSH-në.

3. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet e kontabilitetit do të rezultojnë, sipas përcaktimit, afërsisht të barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësime dhe supozime të cilat kanë ndikimin më të madh në shumat e paraqitura në pasqyrat financiare janë përfshirë në notën 20 "Detyrime të mundshme".

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar vazhdimisht dhe janë të bazuar në përvojën historike dhe faktorë të tjerë, përfshirë parashikimet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet se janë të arsyeshme në rrethanat.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet e kontabilitetit do të rezultojnë, sipas përcaktimit, afërsisht të barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësime dhe supozime të cilat mund të kenë një ndikim në vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar më poshte.

3. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Opsioni i shtyrjes dhe përfundimit. Opsionet e shtyrjes dhe përfundimit janë të përfshirë në një numër të konsiderueshëm të qirave. Ato përdoren për të maksimizuar fleksibilitetin operacional në terma të menaxhimit të aktiveve të përdorura gjatë aktiviteteve të ndryshme.

Në përcaktimin e kohëzgjatjes së qirasë, Drejtimi konsideron të gjithë faktorët dhe rrethanat të cilat mund të nxisin ushtrimin e opsionit të shtyrjes apo përfundimit. Opsioni i shtyrjes përfshihet në periudhën e qirasë vetëm atëherë kur ekziston një siguri në shtyrjen (ose mos përfundimin) e qirasë.

Faktorët e mëposhtëm janë zakonisht më të rëndësishmit:

- Nese nuk ka penalitete të konsiderueshme për përfundimin e qirasë, Shoqëria është zakonisht e sigurt për të shtyrë (mos përfunduar) qiranë.
- Nese përmirësimet e ndërtesës pritet të kenë një vlerë të rëndësishme të mbetur, Shoqëria është zakonisht e sigurt për shtyrjen (mos përfundimin) e qirasë
- Gjithashtu, Shoqëria, konsideron faktorë të tjere duke përfshirë kohëzgjatjen historike të qirasë dhe koston e ndërprerjes së biznesit të kërkuar për zëvendësimin e aktivitetit.

Pjesa më e madhe e opsioneve për qiratë e zyra dhe mjeteve të transportit nuk janë përfshirë në detyrimin e qirasë sepse Shoqëria mund ti zëvendësojë pa kosto të rëndësishme apo ndërprerje të biznesit.

Afati i qirasë ripërcaktohet nëse opsioni ushtrohet (ose jo) ose Shoqëria detyrohet ta ushtrojë (ose jo). Përcaktimi i sigurisë për shtyrjen ose jo rishikohet nëse ka ndryshime të rëndësishme të cilat ndodhin, i cili afekton këtë përcaktim dhe është nën kontrollin e qiramarrësit.

4. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 Janar 2016 dhe efektive për periudhën raportuese duke filluar nga 1 Janar 2019). Shoqëria vendosi të aplikojë standardin që prej 1 Janar 2019 duke përdorur metodën e modifikimit retrospektiv, duke përdorur thjeshtimet e ofruara nga standardi. Aktivitetet me të drejtë përdorimit për ndërtesat janë llogaritur sikur rregullat e reja të ishin të aplikueshme që më parë. E drejta e përdorimit për aktivitetet e tjera është llogaritur bazuar në shumën e detyrimit (e ndryshuar për shpenzimet e parapaguara apo të shtyra). Në aplikimin e SNRF 16 për herë të parë Shoqëria ka përdorur elementët e mëposhtëm të lejuar nga standardi:

- aplikimi i një norme të njëjtë skontimi për qiratë me karakteristika të njëjta
- mbeshetja në përcakime të mëparshme nëse qiratë janë të vështira si një alternative për të performuar një rishikim të daljes nga përdorimi – nuk ka kontrata të vështira ne date 1 Janar 2019
- regjistrimi i qirave operative me një periudhë të mbetur për me pak se 12 muaj në 1 Janar 2019 si qira afatshkurtër
- mospërfshirja e kostove direkte në llogaritjen e Aktive me të drejtë përdorimit në datën e aplikimit fillestarë
- përdorimi i arsytimit për të përcaktuar kohëzgjatjen e qirasë kur qiraja përmban opsionin për shtyerje ose përfundim.

Shoqëria ka zgjedhur të mos ripërcaktojë nëse një kontratë është apo përmban një qira në datën fillestare të aplikimit. Për kontratat e hyra në fuqi para datës së aplikimit Shoqëria është bazuar në përcaktimin e parashikuar duke aplikuar SNK 17, Qiratë, and KIRFN 4, *Të përcaktosh nëse një kontratë përmban Qira.*

Norma e skontimit e aplikuar nga Shoqëria në detyrimet e qirasë është në 1 Janar 2019 ishte 8.46% për detyrimet në Euro dhe 8.46% për detyrimet në Lek.

Në 31 Dhjetor 2018 Shoqëria ka qira të papërfundueshme në vlerë 40,040,961 Lek. Nga këto 263,189 Lek lidhet me qira afatshkurtër të cilat njihen në një bazë lineare si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2019.

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në mijë LEK, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

4. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara (vazhdim)

Një krahasim i qirasë operative të paraqitur në përmbledhjen 9 me detyrimin e njohur është si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018 / 1 Janar 2019
Pagesat e ardhshme të qirasë operative të pa përfundueshme para afatit në 31 Dhjetor 2018 (Përmbledhje 24)	40,040
- Detyrimet e qirasë të njohura në 31 Dhjetor 2018	48,971
- Pagesa të ardhshme të qirasë që janë rezultat i një trajtimi të ndryshëm të opsioneve të përfundimit dhe shtyerjes	-
- Pagesat e ardhshme të ndryshueshme që bazohen në një indeks ose normë	-
- Efekti i aktualizimit	-
- Qira afatshkurtër e panjohur si detyrim	-
- Qira për aktive me vlerë të vogël e panjohur si detyrim	263
Total i detyrimeve të qirasë më 1 Janar 2019	
Nga të cilat janë:	
Detyrime afatshkurtra për qira	35,276
Detyrime afatgjata për qira	13,695

* Qiratë e papërfundueshme përfshijnë ato që mund të anulohen vetëm: (a) me shfaqjen e ndonjë kushti të largët, (b) me lejen e qiradhënësit, (c) nëse qiramarrësi hyn në një qira të re për të njëjtën ose një aktiv të barasvlefshëm me të njëjtin qiradhënës; ose (d) pas pagesës nga qiramarrësi i një shume të tillë shtesë që, në fillimin e qirasë, vazhdimi i qirasë është i sigurt.

Ndryshimi ne standartin kontabël ndikoi elementët e mëposhtëm në pasqyrën e pozicionit financiar më 1 Janar 2019:

	Notes	Aplikimi i SNRF 16
Ulje në Aktivet afatgjatë		-
Rritje e Aktiveve me të drejtë përdorimi		50,302
Rritje / (Ulje) në tatimin e shtyrë		-
Ulje llogari të arkëtueshme		-
Ulje në hua		-
Rritje në detyrimet e qirasë		48,971
Rritje / (Ulje) kapital		-

Standartet e mëposhtme u bene efektive më 1 Janar 2019 por nuk patën ndonje efekt material në Shoqërinë:

- KIRNF 23 “Paqartësi mbi Trajtimet e Tatimit mbi të Ardthurat” (publikuar në 7 qershor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2019)
- Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ - Ndryshime në SNRF 9 (publikuar në 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2019)
- Ndryshimet në SNK 28 "Interesat afatgjata në bashkëpunëtorë dhe sipërmarrje të përbashkët" (publikuar në 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2019).
- Përmirësime Vjetore të Ciklit të SNRF 2015-2017 - ndryshime në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23 (publikuar në 12 Dhjetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 19 "Plani i ndryshimit, ndalimit ose zgjidhjes" (publikuar në 7 shkurt 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019).

5. Standarde dhe interpretime të reja

Disa standarte dhe interpretime janë publikuar dhe janë të detyrueshme për periudhën prej 1 Janar 2020, por që Shoqëria nuk i ka aplikuar më herët.

- Ndryshime në Kornizën Konceptuale për Raportimin Financiar (publikuar më 29 Mars 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 Janarit 2020). Kuadri Konceptual i rishikuar përfshin një kapitull të ri për matjen; udhëzime për raportimin e performancës financiare; përkufizime dhe udhëzime të përmirësuara - veçanërisht përcaktimi i një detyrimi; dhe sqarime në fusha të rëndësishme, të tilla si rolet e administrimit, maturisë dhe pasigurisë së matjes në raportimin financiar.
- Shitja ose Kontributi i Aseteve midis një Investitori dhe Ndërmarrjes së Përbashkët të Tij - Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28 (publikuar në 11 Shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas një date që do të përcaktohen nga BSNK).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit" (publikuar më 18 maj 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2021).
- Përkufizimi i një biznesi - Ndryshime në SNRF 3 (publikuar në 22 Tetor 2018 dhe efektive për blerjet nga fillimi i periudhës vjetore të raportimit që fillon në ose pas 1 Janarit 2020).
- Përkufizimi i materialitetit - Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 (publikuar në 31 tetor 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2020).
- Reforma e normës së interesit - Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7 (publikuar në 26 Shtator 2019 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2020). Nëse nuk përkrahë ndryshe më lart, standardet dhe interpretimet e reja nuk pritet të ndikojnë ndjeshëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

6. Manaxhimi i rrezikut financiar

Aktivitetet e Shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare, si: rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i kreditit, dhe rreziku i normave të interesit. Shoqëria nuk ka një program të shkruar për manaxhimin e rrezikut, por manaxhimi i pergjithshëm i rrezikut në lidhje me këto rreziqe kryhet nga departamenti i financës i Shoqërisë dhe nga departamenti i administrimit të shoqërisë mëmë.

Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria blen cigare për rishitje nga furnizues të huaj dhe shlyen detyrimet e saj në euro. Të ardhurat nga shitja janë realizuar në tregun e brendshëm në Lek. Gjithashtu, shoqëria merr pjesë në transaksione ndërkombëtare dhe është e ekspozuar ndaj rrezikut të këmbimit valuator që rrjedh nga ekspozimi i monedhës vendase ndaj luhatjeve të monedhës së huaj, kryesisht euro dhe franga zvicerane.

Shoqëria përdor funksionin e thesarit në grup për të mbuluar rrezikun që lindë nga transaksionet tregtare të shprehura në monedhë që nuk është monedha që përdor shoqëria.

Përqendrimi kryesor i shoqërisë ndaj rrezikut të këmbimit valuator është drejt euro dhe franges zvicerane. Shoqëria nuk përdor instrumente derivative për tu mbrojtur nga ekspozimet kundrejt rrezikut të këmbimit valutor.

Ekspozimi i shoqërisë ndaj rrezikut të këmbimit valutor është si vijon:

31 dhjetor 2019						
Në mijë ALL	EUR	USD	CHF	GBP	ALL	Total
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	-	-	-	-	922,705	922,705
Llogari të arkëtueshme	-	-	-	-	-	-
	-	-	-	-	922,705	922,705
Llogari të pagueshme	906,287	153	8,980	724	94,124	1,010,268
Detyrime per qiranë					93,563	93,563
	906,287	153	8,980	724	187,685	1,103,831
Ekspozimi valutor më 31 dhjetor 2019	(906,287)	(153)	(8,980)	(724)	735,020	(181,126)

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në mijë LEK, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

6. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)

31 dhjetor 2018						
Në mijë ALL	EUR	USD	CHF	GBP	ALL	Total
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	-	-	-	-	1,002,728	1,002,728
Llogari të arkëtueshme	-	-	-	-	17,929	17,929
	-	-	-	-	1,020,657	1,020,657
Llogari të pagueshme	783,851	75	11,530	434	46,783	842,673
	783,851	75	11,530	434	46,783	842,673
Ekspozimi valutor më 31 dhjetor 2018	(783,851)	(75)	(11,530)	(434)	973,874	177,985

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat e huaja kryesore të aplikuara gjatë vitit :

ALL	Kursi mesatar		Kursi në datën e raportimit	
	2019	2018	2019	2018
USD	109.85	108.00	108.64	107.82
EUR	123.00	127.57	121.77	123.42
CHF	110.57	110.45	112.3	109.60
GBP	140.15	144.19	143	137.42

Analiza e ndjeshmërisë

Duke marrë parasysh zhvlerësimin e Lekut Shoqëria synon të reduktojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në të ardhurat e saj. Në perspektivën afatgjatë, ndryshimet e përhershme në kurset e këmbimit të monedhave të huaja dhe normave të interesit mund të kenë ndikim në fitim.

Më 31 dhjetor 2019, nëqoftëse Leku do të kishte pësuar ngritje/ulje mesatarisht +/- 5% përkundrejt Euro-s, duke marrë parasysh se të gjithë faktorët e tjerë do të jenë konstant, fitimi pas tatimit për vitin do të kishte qënë LEK 45,314 mijë më e ulët/lartë (2018: humbja për vitin do të kishte qënë LEK 39,193 mijë më i lartë/ulët), kryesisht si rezultat i humbjes/fitimit nga shkëmbimi në monedhat e huaja si Euro të dominuara nga huatë dhe llogaritë e pagueshme.

Rreziku i normës së interesit mbi flukset monetare dhe vlerën e drejtë

Rrreziku i normës së interesit të flukseve monetare është rreziku që flukset monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të luhaten për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Vlera e drejtë e rrrezikut të normës së interesit është rreziku se vlera e një instrumenti financiar do të luhetet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Shoqëria ekspozohet ndaj efekteve të luhatjeve në nivelet mbizotëruese të normave të interesit të tregut si ndaj vlerës së drejtë ashtu dhe ndaj rrrezikut të rrjedhës së parasë. Marzhet e interesit mund të rriten si rezultat i ndryshimeve të tilla, por mund të ulë humbjet në rast ndryshimesh të papritura.

Rreziku i normës së interesit mbi flukset monetare dhe vlerën e drejtë (vazhdim)

Tabela e mëposhtme përmbledh ekspozimin e vlerës së drejtë të Shoqërisë ndaj rrrezikut të normës së interesit. Ajo përfshin instrumente financiare të Shoqërisë me vlerat e mbetura te kategorizuara nga rivlerësimi më i hershëm.

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2019**

(Shumat në mijë LEK, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

6. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

31 dhjetor 2019	Deri në 3 muaj	Deri në 6 muaj	Pa Interes	Totali
në mijë Lekë	ALL	ALL	ALL	ALL
Aktive financiare				
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	922,705	-	-	922,705
Llogaritë të arkëtueshme	-	-	-	-
Totali aktiveve financiare	922,705	-	-	922,705
Detyrimet financiare				
Llogari të pagueshme	-	-	1,010,268	1,010,268
Totali detyrimeve financiare	-	-	1,010,268	1,010,268
Ekspozimi nga rivlerësimi i interesit	922,705	-	(1,010,268)	(87,563)

31 dhjetor 2018	Deri në 3 muaj	Deri në 6 muaj	Pa Interes	Totali
në mijë Lekë	ALL	ALL	ALL	ALL
Aktive financiare				
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	1,002,728	-	-	1,002,728
Llogaritë të arkëtueshme	-	-	17,930	17,930
Totali aktiveve financiare	1,002,728	-	17,930	1,020,658
Detyrimet financiare				
Llogari të pagueshme	-	-	842,672	842,672
Totali detyrimeve financiare	-	-	842,672	842,672
Ekspozimi nga rivlerësimi i interesit	1,002,728	-	(824,743)	177,985

Shoqëria nuk ka asnjë aktiv ose detyrim me vlerë të drejtë që mbart normë fikse interesi dhe si rrjedhojë nuk njuh asnjë humbje ose fitim, gjithashtu Shoqëria nuk përdor asnjë derivat. Për këtë arsye, një ndryshim në normat e interesit në datën e raportimit nuk do të ndikojë në fitimin ose humbjen.

Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare për Shoqërinë, nëse një klient ose pala e lidhur nga një instrument financiar nuk arrijnë të përmbushin detyrimet kontraktuale, dhe rrjedh kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të shoqërisë nga klientët.

Rreziku i kredisë vjen edhe nga mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre si dhe depozitat në banka, ekspozimet e kreditit ndaj klientit, duke përfshirë arkëtimet dhe transaksionet e kryera të pashlyera në rastin kur klienti i tij kryesor nuk ka aftësinë për të përmbushur detyrimet e tij.

Shoqëria ka vetëm një klient i cili ka si afat pagese prej 6 ditë, prandaj Shoqëria nuk ka rrezik përqëndrimi të rëndësishëm të kredisë.

Ekspozimi maksimal i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë është si më poshtë:

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2019**

(Shumat në mijë LEK, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

6. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Aktivët financiarë		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	922,705	1,002,728
Klientë dhe llogari të tjera të arkëtueshme	-	17,930
Llogari të arkëtueshme nga palet e lidhura	83,409	
Totali	1,006,114	1,020,658

Rreziku i likuiditetit

Menaxhimi i kujdesshëm i rrezikut të likuiditetit nënkupton mbajtjen e mjaftueshme të parave të disponueshme në mënyrë që të permbushen të gjitha detyrimet financiare në kohë. Departamenti i financave rregullisht monitoron burimet e disponueshme të parave dhe ka një fokus të fortë në rrjedhën e parave duke përditësuar parashikimet ditore dhe mujore.

Tabela e mëposhtme analizon detyrimet financiare të shoqërisë në grupime sipas maturimit përkatës të bazuar në periudhën e mbetur në pasqyrën e pozicionit financiar deri në datën e maturimit kontraktual. Shumat e paraqitura në tabelë janë flukse monetare të parasë të pa skontuara. Shumat që janë për tu paguar brend 12 muajve janë të barabartë me vlerën e tyre historike sepse impakti i skontimit nuk është material.

	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	Më shumë se 3 muaj	Total
31 dhjetor 2019				
<i>Aktive financiare</i>				
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	922,705	-	-	922,705
Llogari të arkëtueshme	-	-	-	-
Totali aktiveve financiare	922,705	-	-	922,705

<i>Detyrime financiare</i>				
Llogari të pagueshme	722,033	288,235	-	1,010,268
Detyrime per qiranë			93,562	93,562
Totali detyrimeve financiare	722,033	288,235	93,562	1,103,830
Ekspozimi i paregulluar i aktiveve dhe detyrimeve	200,672	(288,235)	(93,562)	(181,125)

	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	Më shumë se 3 muaj	Total
31 dhjetor 2018				
<i>Aktive financiare</i>				
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	1,002,728	-	-	1,002,728
Llogari të arkëtueshme	17,930	-	-	17,930
Totali aktiveve financiare	1,020,658	-	-	1,020,658

<i>Detyrime financiare</i>				
Llogari të pagueshme	485,422	357,250	-	842,673
Totali detyrimeve financiare	485,422	357,250	-	842,673
Ekspozimi i paregulluar i aktiveve dhe detyrimeve	535,235	(357,250)	-	177,985

Edhe pse ekspozimi i likuiditetit është negativ, shumica e llogarive të pagueshme me maturitet 90 ditë lidhen me Philip Morris International Tolling SA e cila është një palë e lidhur. Një linjë kredie në vlerë prej 100 milionë lekë është në dispozicion me Intesa San Paolo Bank Albania me normë të veçantë të interesit në indeksin e bonove të thesarit 6-mujore plus 100 bps, e cila nuk është përdorur gjatë vitit 2019. Shoqëria rinovon kredin çdo vit, marrëveshja aktuale skadon në 20 tetor 2020.

6. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Bazuar ne Ligjin e akcizës nr. 61/2012 që ka hyrë në fuqi më 1 tetor 2012, e cila lejon pagesën e shtyrë të akcizës me kusht depozitimin e një garancie bankare valide pranë autoriteteve doganore, që nga 24 shtator 2012 një marrëveshje është nënshkruar mes Philip Morris Albania Sh.p.k. dhe Intesa SanPaolo Bank Albania. Shuma e marrëveshjes është ALL 1,600,000,000 (një miliard e dy njëqind mijë lekë) me një komision prej 0.38% p.a. Kjo marrëveshje është shtyrë deri në 20 tetor 2020.

Më 11 korrik 2015, Intesa SanPaolo Bank Albania ka lëshuar garanci në shumën lekë 78.000.000 (shtatëdhjetë e tetë milion Lek) kundrejt autoriteteve tatimore, dhe mbulon detyrimet dhe interesat e vendosura nga organet tatimore për shkak të një inspektim tatimor ndjekur nga njoftimi për detyrimet nr. 2442/13 datë 16 qershor 2014 dhe 2442/16 datë 26 qershor 2014. Kjo garanci është shtyrë deri në 20 tetor 2020.

7. Menaxhimi i kapitalit

Objektivat e Shoqërisë gjatë menaxhimit të kapitalit janë:

Të ruajnë aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, në mënyrë që të sigurojë kthimin e kapitalit për pronarët dhe për të mbajtur një strukturë optimale të kapitalit dhe për të ulur koston e kapitalit

Totali i kapitalit është llogaritur si "kapital" siç tregohet në bilanc plus borxhin neto.

Me qëllim mbajtjen dhe korigjimin e strukture së kapitalit shoqëria mund të ndryshoj shumën e fitimit që i shperndahet aksionereve, shpërndarjen e kapitalit tek aksioneret, shtimin e kapitalit ose shitjen e aktiveve për të ulur borxhet.

Shoqëria nuk ka hua afatgjata. Shoqëria nuk është institucion financiar dhe si rrjedhojë nuk është e detyruar të jetë në pajtueshmeri me asnjë kërkesë mbi kapitalin të vendosura nga rregullatorët.

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në mijë LEK, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

8. Aktive afatgjata materiale

Aktive afatgjata materiale janë analizuar si më poshtë:

Kosto	Mobilje	Transport	Pajisje elektronike	Përmirësime të ndërtesës	Ndërtime në proces	Total
Më 1 janar 2018	198,427	65,618	39,164	8,411	531	312,151
Shtesat	6,866	-	4,953	-	2,563	14,382
Pakësimet	(9,727)	(15,863)	(2,707)	-	(531)	(28,827)
Më 31 dhjetor 2018	195,566	49,755	41,410	8,411	2,563	297,706
Më 1 janar 2019	195,566	49,755	41,410	8,410.6900	2,563	297,706
Shtesat	20,167	-	4,822	1,590.7145	29,780	56,359
Pakësimet	(4,690)	-	(4,669)	-	(2,563)	(11,922)
Më 31 dhjetor 2019	211,043	49,755	41,563	10,001	29,780	342,143
	195,566	49,755	41,410	8,410.6900	2,563	297,706
Amortizimi akumuluar						
Më 1 janar 2018	(129,493)	(44,531)	(20,644)	(7,149)	-	(201,816)
Shtesat	(26,106)	(13,021)	(9,464)	(1,262)	-	(49,853)
Pakësimet	8,482	15,862	1,786	-	-	26,129
Më 31 dhjetor 2018	(147,117)	(41,690)	(28,322)	(8,411)	-	(225,540)
Më 1 janar 2019	(147,117)	(41,690)	(28,322)	(8,411)	-	(225,540)
Shtesat	(26,150)	(7,211)	(8,143)	(530)	-	(42,034)
Pakësimet	3,528	-	2,566	-	-	6,094
Më 31 dhjetor 2019	(169,740)	(48,901)	(33,899)	(8,941)	-	(261,480)
Vlera Kontabël Neto						
Më 31 dhjetor 2018	48,449	8,065	13,088	-	2,563	72,165
Më 31 dhjetor 2019	41,303	854.4	7,664	1,061	29,780	80,662

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2019**

(Shumat në mijë LEK, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

9. Aktive me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë

Shoqëria ka marrë me qira aktive të ndryshme për shembull: ndërtesë, magazinë, mjete transporti dhe shtëpi për punonjësit e huaj të ardhur me detyrë afatshkurtër. Kontratat e qirasë janë zakonisht për periudha fikse midis 1 dhe 4 vjet por mund të kenë mundësinë e rinovimit.

Deri më 31 Dhjetor 2018 qiraja për aktivet afatgjata klasifikohet si qira financiare ose si qira operative. Nga 1 Janar 2019, qirate njihen si aktive me të drejtë përdorimi dhe në të njëjtën kohë njihet dhe detyrimi respektiv që prej datës kur aktivet e marra me qira bëhen të gatshme për përdorim nng Shoqëria.

In mijë Lek (ALL)	Ndërtesa	Transport	Të tjera	Total
Më 1 Janar 2019	22,940	15,882	11,480	50,302
Shtesat	58,026	14,961	8,147	81,134
Pakësimet	-	-	(4,456)	(4,456)
Amortizimi	(20,622)	(7,608)	(6,326)	(34,557)
Dalja jashtë përdorimit	-	-	-	-
Efekti i kursit të këmbimit	(124)	(153)	(110)	(387)
Të tjera	-	-	(972)	(972)
Më 31 Dhjetor 2019	60,219	23,082	7,762	91,064

Shoqëria ka njohur detyrime për qiranë si më poshtë:

<i>Në mijë Lek ALL</i>	31 Dhjetor 2019
Detyrime afatshkurtra për qiranë	17,702
Detyrime afatgjata për qiranë	75,860
Totali i detyrimeve për qiranë	93,562

Shpenzimet e interesit të përfshira në kostot financiare të 2019 ishin ALL 3,222 mijë.

Shpenzimet e lidhura me qiratë afatshkurtër (të përfshira në shpenzimet administrative) dhe të qirave për aktivet me një vlerë të ulët të cilat nuk janë të paraqitura tek kategoria e qirave afatshkurtër.

<i>Në mijë Lek ALL</i>	2019
Shpenzime për qiratë afatshkurtër	4,986
Shpenzime për qiratë e aktiveve me vlerë të ulët	1,396

Totali i pagesave të bëra për qiratë në 2019 ishte ALL 35,584.88 mijë.

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2019**

(Shumat në mijë LEK, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

9. Aktive me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë (vazhdim)

Marrëveshja e qirasë nuk imponon ndonjë marrëveshje tjetër përveç sigurimit të interesave për aktivet që mbahen nga qiradhënësi. Aktivet e marra me qira nuk mund të përdoren si kolateral për hua.

Shtyrja dhe përfundimi janë opsione të përfshira në një numër të konsiderueshëm të qirave për aktivet e Shoqërisë. Këto kushte përdoren për të maksimizuar fleksibilitetin operacional në menaxhimin e aseteve që Shoqëria përdor për operacionet e saj. Pjesa më e madhe e opsioneve të shtyerjes dhe përfundimit janë të ushtrueshme vetëm nga ana e Shoqërisë dhe jo nga qiradhënësi.

Afati i qirasë ripërcaktohet nëse opsioni ushtrohet (ose jo) ose Shoqëria detyrohet ta ushtrojë (ose jo). Përcaktimi i sigurisë për shtyerjen ose jo rishikohet nëse ka ndryshime të rëndësishme të cilat ndodhin, i cili afekton këtë përcaktim dhe është nën kontrollin e qiramarrësit.

10. Aktive tatimore të shtyra

Lëvizja në aktivet tatimore të shtyra analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Në fillim të vitit (Ngarkuar)/kredituar në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse	6,869	10,047
	5,395	(3,178)
Total	12,265	6,869

Norma tatimore e aplikueshme për qëllimet e llogaritjes së tatimeve të shtyra është 15% (2018: 15%).

Të gjitha lëvizjet në tatimin e shtyrë janë njohur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

	Amortizim i përsheptuar	Çregjistrim i inventarit	Pagesa me bazë aksione	Pensione	Shpenzime të përlllogaritura për punonjësit e huaj	Qira	Total
31 dhjetor 2017	3,576	106	2,481	1,170	2,714		10,047
(Ngarkuar)/ kredituar në fitim ose humbje	5,690	(106)	(2,988)	(1,052)	(4,722)		(3,178)
31 dhjetor 2018	9,266	-	(507)	118	(2,008)		6,869
(Ngarkuar)/ kredituar në fitim ose humbje	1,415	-	330	918	2,208	375	5,395
31 dhjetor 2019	10,681	-	(178)	1,036	200	375	12,265

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2019**

(Shumat në mijë LEK, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

11. Inventari

Inventari përshkruhet në tabelën e mëposhtme:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mallrat e përfunduara	1,822,469	1,181,955
Çregjistrim i inventarit	-	(29,807)
Total	1,822,469	1,152,148

Lëvizja në çregjistrimin e inventarit gjate fundit te vitit më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 analizohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Çregjistrimi në fillim të vitit	29,807	29,807
Kosto e periudhës	-	-
Rimarrje gjatë vitit	29,807	-
Total	-	29,807

12. Llogari dhe të tjera të arkëtueshme

Llogari dhe të tjera të arkëtueshme përshkruhen në tabelën në vijim:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	83,409	
Të arkëtueshme nga klientë tjerë	-	17,930
Të tjera të shtyra	1,043	944
Të tjera të arkëtueshme	44,627	20,054
Total	129,079	38,928

Të tjera të arkëtueshme përshkruhen në tabelën në vijim:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Parapagime për furnitorët	26,554	8,349
Taksë akcize e arkëtueshme	11,239	11,429
Parapagime të tjera	6,835	276
Total	44,627	20,054

Vlera e akcizës për t'u rimbursuar i përket pjesës së mallrave që janë për t'u shkatërruar, rimbursimi për të cilat do të bëhet nga autoritetet tatimore. Shoqëria është e bindur se do të rimbursohet për gjithë vlerën e akcizës meqënëse ajo lidhet me mallrat për t'u shkatërruar për të cilat është ndjekur procedura sipas ligjeve në fuqi.

Vlera kontabël e llogarive të tjera të arkëtueshme është në Lekë.

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë, këmbimit valutës dhe humbjes nga zhvlerësime për llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera janë paraqitur në shënimin shpjegues 6.

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në mijë LEK, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

13. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Gjendja në bankë		
Në monedhën vendase	922,705	1,002,728
Totali	922,705	1,002,728

Mjetet monetare në bankë janë mbajtur në banka me renditje AA-. Ekspozimi i shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë, këmbimit valutor dhe humbjes nga zhvlerësime për llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera janë paraqitur në shënimin shpjegues 6.

14. Kapitali Aksionar

	Numri i aksione të zakonshme	Vlera në LEK
Më 31 dhjetor 2018	1,000	29,000
Më 31 dhjetor 2019	1,000	29,000

Kapitali aksionar i Shoqërisë zotërohet plotësisht 100% nga Philip Morris SA. Shoqëria mëmë është Philip Morris International Inc.

Pagesat e bazuara në aksione

Shoqëria operon me një numër të planeve të kompensimit të bazuara në aksione të rregulluara me kapital neto, sipas të cilave njësia ekonomike merr shërbime nga punonjësit si shpërblim për aksionet në kapitalin e Shoqërisë.

Punonjësit e kualifikuar marrin kompensime afatgjata të kapitalit që dorëzojnë aksionet e PMI pas një periudhe shërbimi trevjeçare.

15. Furnitorë dhe detyrime të tjera

Furnitorë dhe detyrime të tjera janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<i>Detyrime financiare</i>		
Furnitorë	103,394	55,692
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura (shënim 24)	906,874	786,981
	1,010,268	842,673
<i>Detyrime jo-financiare</i>		
Detyrime të tjera	332,803	248,895
Taksat dhe detyrimet	11,249	5,093
Detyrimi tatimor i akcizës	1,391,112	828,409
Detyrimi tatimor i TVSH	35,038	17,434
	1,770,203	1,099,831
Total	2,780,472	1,942,504

Detyrimet ndaj palëve të lidhura përbëhen kryesisht nga detyrimet ndaj Philip Morris SA për blerjen e cigareve nga fabrikat e prodhimit bazuar kryesisht në Poloni, të cilat nuk janë paguar në fund të vitit. Termat e pagesës janë brenda 90 ditëve.

Llogaritë e pagueshme për palët e lidhura janë paraqitur në shënimin shpjegues 24. Ekspozimi i Shoqërisë për likuiditetet dhe rrezikut nga këmbimi valutor që dalin nga llogaritë e pagueshme janë paraqitur në shënimin shpjegues 6.

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2019**

(Shumat në mijë LEK, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

15. Furnitorë dhe detyrime të tjera (vazhdim)**Detyrime të tjera**

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shpenzime të përlogaritura për shitje dhe marketing	133,836	90,307
Shpenzime administrative të përlogaritura	80,036	46,225
Të tjera shpenzime	118,931	112,363
Total	332,803	248,895

Shpenzimet e përlogaritura të marketingut dhe të shitjeve janë gjerësisht të lidhura me shitjen e produktit dhe bazohen në kontrata të rena dakort. Shpenzimet administrative të përlogaritura përfshijnë shpenzime të përlogaritura për energji, ujë, telekomunikacion, si dhe parashikime për shpenzime të tjera si kosto trainimesh, shpenzime auditimi, shërbime ligjore dhe bonuse për punonjësit. Të tjera shpenzime përfshijnë detyrimet për autoritetet tatimore nga inpektimet tatimore të kryera më 2014 dhe 2016. Për të parë detajet lidhur me këto shpenzime referojuni shënimit shpjegues 25.

16. Të ardhurat

Të ardhurat të paraqitura në pasqyrat e të ardhurave janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të ardhura neto nga shitjet e mallrave	10,756,335	10,659,943
Total	10,756,335	10,659,943

Shitjet janë paraqitur në vlerën neto duke zbritur kompensimin tregtar dhe tatimin mbi vlerën e shtuar, por bruto për sa i përket akcizës.

17. Kosto e mallrave të shitur

Shpenzimet e mallrave të shitura, të paraqitura në pasqyrat e të ardhurave janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Kosto e mallrave të shitur	9,884,933	9,672,500
Total	9,884,933	9,672,500

Kosto e mallrave të shitura përfshin, koston e mallrave (koston e blerjes), koston e taksës së akcizës, dhe kosto të tjera të lidhura me blerjet.

18. Shpenzime të shitjes, distribucionit dhe administrative

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shpenzime të shitjes dhe distribucionit	438,658	331,515
Shpenzime administrative	323,144	329,894
Total	761,802	661,409

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2019**

(Shumat në mijë LEK, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

18. Shpenzime të shitjes, distribucionit dhe administrative (vazhdim)

Shpenzime të shitjes, distribucionit dhe administrative janë të analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Shpenzime për komunikim	234,355	186,632
Shpenzime të tjera	127,472	96,135
Kosto personeli	119,439	102,663
Shpenzime brenda grupit	92,451	86,552
Kompensimi për menaxhimin kryesor	45,843	45,756
Shpenzime amortizimi dhe zhvlerësimi	42,034	49,853
Shpenzime zhvlerësimi aktive me të drejtë përdorimi	34,556	-
Shpenzime qiraje	5,076	-
Shpenzime për automjetet e Shoqërisë	16,174	25,498
Kërkim e studim tregu	15,777	25,306
Shpenzime akomodimi	8,815	7,159
Shpenzime ligjore	7,202	5,908
Shpenzime transporti	5,824	8,031
Telefone/celular/shpenzime interneti	4,392	3,916
Mirëmbajtje dhe riparime PPOSM	2,392	2,483
Qira për zyra dhe magazinë	-	15,517
Total	761,802	661,409

Shpenzimet e personelit të pasqyruara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Rrogat dhe përfitime të tjera të punonjësve	108,572	93,411
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	10,867	9,252
Total	119,439	102,663

Shpenzime të tjera janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shërbime konsulence	35,801	35,280
Kontribute për bamirësi	32,868	-
Të tjera	21,364	17,920
Shpenzime për punonjesit e huaj	10,628	18,626
Shpenzime udhëtim/akomodim	8,545	6,361
Shpenzime trajnimit për punonjësit	5,519	5,285
Shpenzime për mbledhje dhe konferenca	4,377	578
Ujë/drita	3,672	3,491
Shpenzime sigurimi	2,127	3,092
Mostra për analiza cigaresh	1,799	1,744
Antarësime	772	3,758
Total	127,472	96,135

Kontributet për bamirësi janë të lidhura me kontributet e shoqërisë për të lehtësuar pasojat e tërmetit.

19. Të ardhura/shpenzime të tjera

Të ardhura të tjera të pasqyruara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Tarifat e shërbimit- palët e lidhura	83,238	-
Të ardhura të tjera	24,222	9,872
Total	107,460	9,872

Të ardhura të tjera pasqyrojnë kryesisht të ardhura nga shitja e paisjeve elektronike dhe mjeteve të transportit.

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2019**

(Shumat në mijë LEK, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

19. Të ardhura/shpenzime të tjera (vazhdim)

Shpenzime të tjera të pasqyruara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Detyrime tatimore	8,781	9,708
Të tjera	17,679	2,347
Total	26,460	12,055

20. Fitim/ (humbje) nga kursi i këmbimit

Diferencat nga kursi i këmbimit të pasqyruara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Humbjet nga transaksionet e këmbimit valutor	(29,323)	(8,242)
Fitimet nga transaksionet e këmbimit valutor	37,401	52,238
Total	8,079	43,995

21. Kosto financiare, neto

Kostot financiare neto, të pasqyruara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të ardhurat nga interes	1,756	2,050
Shpenzime për interesa mbi huatë bankare	-	(7,263)
Shpenzime për interesa mbi qiratë operative	(3,222)	-
Total	(1,465)	(5,213)

22. Tatimi mbi fitimin

Detyrimi tatimor për vitin është paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Tatim fitimi aktual	41,720	64,573
Tatimi i shtyrë (shënimi 10)	(5,396)	3,179
Total	36,324	67,752

Norma e tatimit mbi të ardhurat është e zbatueshme në të ardhurat e Shoqërisë në të dyja vitet në vlerën 15%.

Shpenzimi për vitin, mund të rakordohet me fitimin e paraqitur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Fitimi/ (humbja) para tatimit	197,211	362,633
Tatim fitimi i përlogaritur 15%	29,582	54,395
Shpenzime të pazbritshme	6,742	13,357
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	36,324	67,752

Aktivet tatimore të shtyra janë klasifikuar për shkak të diferencave të përkohshme që lindin midis vlerës së tatueshme dhe vlerës kontabël të aktiveve të Shoqërisë. Detaje të llogaritjes së aktiveve tatimore të shtyra janë paraqitur në shënimin shpjegues 10.

23. Detyrime të mundshme**Tatimet**

Cështja 2 B: Kjo çështje gjyqësore e iniciuar nga Zyra e Tatimpaguesve të Mëdhenj/Drejtoria Rajonale e Tatimeve lidhet me Njoftimin për Vlerësimin Tatimor nr. 8679 / 4 të datës 19.08.2013 të lëshuar nga e njëjta zyrë dhe Drejtoria e Apelimit Tatimor ("DAT") Vendimi nr. 16700/2 datë 18.12.2013.

Shoqëria u thirr në këtë proces gjyqësor për të marrë pjesë në cilësinë e palës së tretë të interesuar në këtë proces gjyqësor. I pandehuri është DAT. Kërkesa e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve ka të bëjë me detyrimet e TVSH-së të vendosura nga e njëjta zyrë në Njoftimin e tyre të Vlerësimit të Taksave të përmendur më lart, e cila më pas ishte refuzuar me Vendimin DAT të përmendur gjithashtu më lart. Detyrimet e TVSH-së u ngarkuan për dështimin e Shoqërisë për lëshimin e faturës tatimore dhe pagimin e TVSH-së gjatë vitit 2010 dhe 2011 për mallrat që i nënshtroheshin tërheqjes nga tregu dhe më pas shkatërrimit.

Gjykata Administrative e shkallës së parë kundërshtoi padinë e Drejtorisë Rajonale të Taksave e cila ka paraqitur një ankesë që pritet të mbahet në vitin 2020.

Shuma për të cilën Shoqëria mund të jetë përgjegjëse në rast të një vendimi të pafavorshëm është 37,094 mijë Lekë. Për shkak të vendimit të favorshëm të gjykatës së shkallës së parë, drejtimi i Shoqërisë konsideron se nuk është e mundshme që do të kërkohet një rrjedhje e përfitimeve ekonomike si rezultat i kësaj çështje dhe për këtë arsye nuk ngriti një provizion në pasqyrat e tij financiare.

Policat e Sigurimit. Shoqëria zotëron polica sigurimi në lidhje me aktivet e saj, operacionet, punonjësit ose rreziqe të tjera të sigurueshme.

Çështje ligjore. Në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë aktualisht nuk ka çështje ligjore, ose pretendime të tjera të papaguara, të cilat mund të kenë një efekt material mbi rezultatin e operativ ose pozicionin financiar të Shoqërisë dhe të cilat nuk janë përlogaritur ose paraqitur në këto pasqyra financiare.

Qiraja operative. Kur Shoqëria ishte qiramarrës, pagesat minimale të ardhshme të papërfundueshme të qirasë operative ishin si me poshtë me datë 31 Dhjetor 2018:

<i>Në mijë Lek</i>	2018
Jo më shumë se 1 vit	26,736
Më shumë se 1 vit por jo më shumë se 5 vite	13,305
Më shumë se 5 vite	-
Total i qirasë operative më 31 Dhjetor 2018	40,041

Garancitë bankare. Bazuar ne Ligjin e akcizës nr. 61/2012 që ka hyrë në fuqi më 1 tetor 2012, e cila lejon pagesën e shtyrë të akcizës me kusht depozitimin e një garancie bankare valide pranë autoriteteve doganore, që nga 24 shtator 2012 një marrëveshje është nënshkruar mes Philip Morris Albania Sh.p.k. dhe Intesa SanPaolo Bank Albania. Shuma e marrëveshjes është ALL 1,600,000,000 (një miliard e dy njëqind mijë lekë) me një komision prej 0.38% p.a. Kjo marrëveshje është shtyrë deri në 20 tetor 2020.

Më 11 korrik 2015, Intesa SanPaolo Bank Albania ka lëshuar garanci në shumën lekë 78.000.000 (shtatëdhjetë e tetë milion Lek) kundrejt autoriteteve tatimore, dhe mbulon detyrimet dhe interesat e vendosura nga organet tatimore për shkak të një inspektim tatimor ndjekur nga njoftimi për detyrimet nr. 2442/13 datë 16 qershor 2014 dhe 2442/16 datë 26 qershor 2014. Kjo garanci është shtyrë deri në 20 tetor 2020.

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Garanci bankare kundrejt autoriteteve tatimore	78,000	78,000
Garanci bankare kundrejt autoriteteve doganore	1,600,000	1,200,000
	1,678,000	1,278,000

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2019

(Shumat në mijë LEK, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

23. Detyrime të mundshme (vazhdim)

Një linjë kredie në vlerë prej 100 milionë lekë është në dispozicion me Intesa San Paolo Bank Albania me normë të veçantë të interesit në indeksin e bonove të thesarit 6-mujore plus 100 bps, e cila nuk është përdorur gjatë vitit 2019. Shoqëria rinovon kredin çdo vit, marrëveshja aktuale skadon në 20 tetor 2020.

24. Transaksionet me palët e lidhura

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019, Shoqëria zotërohej plotësisht nga Philip Morris S.A. Sëitserland, e cila zotërohet nga Philip Morris International Inc. Palët e lidhura, përfshijnë të gjitha shoqëritë anëtare të Philip Morris International Inc.

Transaksionet e mëposhtme u kryen me palë të lidhura:

31 dhjetor 2019	Shoqëria mëmë	Palë të lidhura	Totali
Llogari dhe të tjera të arkëtueshme	-	83,409	83,409
Llogari dhe të tjera të pagueshme	-	906,874	906,874

31 dhjetor 2019	Shoqëria mëmë	Palë të lidhura	Totali
Blerje produktesh	-	3,500,493	3,500,493
Blerje shërbimesh	-	56,886	55,885
Të ardhura të tjera	-	-	-

31 dhjetor 2018	Shoqëria mëmë	Palë të lidhura	Totali
Llogari dhe të tjera të arkëtueshme	-	-	-
Llogari dhe të tjera të pagueshme	-	786,981	786,981

31 dhjetor 2018	Shoqëria mëmë	Palë të lidhura	Totali
Blerje produktesh	-	3,361,643	3,361,643
Blerje shërbimesh	-	132,308	132,308
Të ardhura të tjera	-	-	-

Kompesimi për menaxhimin kryesor

Menaxhimi kryesor përbëhet nga drejtori i Shoqërisë. Kompensim i paguar ose që duhet paguar për drejtuesin kryesor është paraqitur më poshtë:

	31 December 2019	31 December 2018
Shperblim bazuar ne aksione	2,195	4,393
Equivalent te dividendit	167	46
Paga	15,400	15,189
Kompensime	4,597	1,817
Sigurim shendetesor	0	2,924
Benefite	13,926	12,732
Pension	504	652
Shpenzime rialokimi	2,542	3,623
Dieta	6,511	4,380
Total	45,843	45,756

25. Ngjarje pas datës së raportimit

Ekzistenca e koronavirusit të ri (COVID-19) u konfirmua në fillim të vitit 2020 dhe është përhapur në territorin e Kinës dhe më gjerë, duke shkaktuar ndërprerje të bizneseve dhe aktivitetit ekonomik. Drejtimi i Shoqërisë e konsideron këtë ngjarje si një ngjarje jo rregulluese pas datës së raportimit. Meqenëse situata po zhvillohet me shpejtësi, ne nuk e konsiderojmë të mundshme të japim një vlerësim sasior të ndikimit të kësaj ngjarje në Shoqëri. Drejtimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndër marrë të gjitha hapat për të lehtësuar çdo efekt.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që do të kërkonin ndryshime në informacionin e pasqyrave financiare.